



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 7 mars 2017

Numri i lëndës: 2016-01

Skender Jashari

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 mars 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar me 28 janar 2016.
2. Me 9 janar 2017, znj. Elka Ermenkova është tërhequr nga kjo lëndë, për shkak të konfliktit të interesit dhe ajo nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e lëndës, në përputhje me Rregullën 12(1)(1) të Rregullores së Punës së Panelit. Ajo ishte zëvendësuar nga znj. Anna Bednarek.

II. FAKTET

3. Faktet e rastit siç janë paraqitur nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:
 - Me 27 maj 2009, "agjentë islamik të Serbisë" janë përpjekur ta rrëmbejnë dhe ta vrisnin atë. Sipas tij, EULEX-i ka dështuar të ndër marrë diçka në lidhje me të.
 - Në natën e pashkëve të vitit 2012, ai ka marrë kërcënime nga burime të pidentifikuara. Prapë ai pretendon se EULEX-i ka dështuar të veprojë.
 - Duke filluar nga viti 2012, me udhëzimet e pretenduara të Ministrit të Jashtëm të Serbisë, ai ishte gjykuar dhe dënuar nga gjykatat e Kosovës dhe anëtarët e familjes së tij ishin kërcënuar.
 - Me 18 dhjetor 2013, shtëpia e tij ishte shkatërruar qëllimisht nga persona të pidentifikuar.
 - Me 7 shkurt 2014, ai dhe vëllai i tij ishin sulmuar dhe me 30 tetor 2014 ata përsëri ishin kërcënuar përdërisa ishin në paraburgim.

III. ANKESAT

4. Ankuesi pohon se EULEX-i ka qenë bashkëpunëtor në këto akte, të cilat në përgjithësi ai ia atribuon Serbisë apo agjentëve të Serbisë.

IV. LIGJI

Parashtresat nga ankuesi

5. Ankuesi nuk i referohet ndonjë të drejte të njeriut të veçantë apo dispozite të të drejtave të njeriut se është shkelur nga ana e EULEX-it. Nga përmbajtja e ankesës së tij, akuzat e bëra duket se kanë të bëjnë me nenin 3, 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa") si dhe nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës.
6. Ankuesi kërkon nga Paneli që të shqyrtoj një dosje të veçantë të një lënde të Gjykatës Themelore të Gjilanit për t'i gjetur *"të gjitha dokumentet që vërtetojnë shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut"* dhe që të zbatohet ligji.

Vlerësimi i Panelit

7. Si një çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën

Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

8. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
9. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Kjo dispozitë më tej përcakton se Paneli nuk është kompetent për të shqyrtuar procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës.
10. Në bazë të Rregullës 25, paragrafi 3, të Rregullores së Punës së Panelit, ankuesi është i detyruar të paraqesë ankesën në afat prej gjashtë muajve nga vepra, vendimi apo sjellje që thuhet se arrin ose përfshinë ndonjë shkelje të të drejtave të tij/saj (për shembull shih *Gashi kundër EULEX-it*, nr. 2013-22, 7 prill 2014 § 10; *Thaqi kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 51; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, 29 shtator 2014, §§ 40 e tutje).
11. Paneli thekson se asnjë prej këtyre veprave të pretenduara nga ankuesi nuk hyjnë brenda afatit të nevojshëm 6 mujor që prej se ka ndodhur shkelja e pretenduar. Edhe vetëm mbi këtë bazë, ankesa është e papranueshme.
12. Lidhur me kërkesën (shih më lartë paragrafin 6) se Paneli duhet të shqyrtojë një dosje të lëndës dhe të zbatoj ligjin, ankuesi nuk ka arritur të shpjegojë se si kjo do të hynte në kuadër të kompetencave të Panelit siç saktësohet në Rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.
13. Së fundi, bazuar në informatat e dhëna nga ankuesi lidhur me faktet e pretenduara, Paneli konstaton se ankuesi nuk ka arritur të vërtetoj pretendimin e tij se EULEX-i do të mund të mbahet përgjegjës për ndonjë prej shkeljeve të pretenduara të të drejtave të tij. Prandaj mund të thuhet se ankesa është qartas e pabazuar dhe njëherësh për atë arsye e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se sipas Rregullit 29(1)(c) dhe (e), kjo ankesë nuk është në përputhje me Rregullën 25(3) të Rregullores së Punës së Panelit dhe kështu bie jashtë afatit, dhe për më tepër e pabazuar, prandaj

E SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese